



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 21.12.2023, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, (LDK), Tria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berat Lahu (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajšhori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB), Endrit Zabërgja (NISMA) dhe Fehmi Kupina (i pavarur).

Munguan: Besnik Mujeci (LVV), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK) dhe Gresa Lahu (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Donika Qetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Osman Bllaca, përfaqësues të OSBE-së, qytetarë të lagjes “Kalabria”, përfaqësues të medieve dhe Florim Krasniqi, përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Bahri Gashi propozoi që pika 7 e rendit të ditës “Projektregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës”, të kalojë në pikën 4 në rend të ditës.

Faqe 1 nga 15

Besart Krasniqi, në emër të GP të LVV-së, propozoi që në rend të ditës të futet pika "Propozimvendimi për lirimin nga pagesa për pjesëtarët e Policisë së Kosovës për shërbimet që ofrohen në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucionet tjera shëndetësore që menaxhohen nga Komuna".

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 2 vota kundër, u miratua propozimi i z. Gashi për ndryshimin e renditjes së pikave të rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, u miratua propozimi i z. Krasniqi që në rend të ditës të futet pika "Vendimi për lirimin nga pagesa për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, për shërbimet që ofrohen nga Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucionet tjera shëndetësore, që menaxhohen nga kryeqyteti.

Me ndryshimet dhe plotësimet në rendin e ditës, kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimin e ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinut dhe Shaban Kongjelit;
3. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Bahtir) Demollit, Albert (Bajram) Mavriqit, Remzush (Bajram) Mavriqit, Hysen (Bajram) Mavriqit dhe Arben (Bajram) Mavriqit;
4. Projektregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;
5. Propozim-vendimi për lënie në shqyrtim publik të prpjektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm "Kalabria", 2023-2031 në Prishtinë;
6. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona ekonomike", në Prishtinë;
7. Propozimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, i dt. 16.06.2010;
8. Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit në mes Kryeqytetit Prishtina dhe Kryeqytetit Kuwait city;
9. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024;
10. Vendimi për lirimin nga pagesa për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, për shërbimet që ofrohen nga Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucionet tjera shëndetësore, që menaxhohen nga Kryeqyteti;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimin e ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 1 kundër, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rahman Haradinit dhe Shaban Kongjelit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, arsyeshmërinë për miratimin e saj e paraqiti Doruntinë Maloku, drejtore.

Nora Kelmendi paraqiti vërejtje rreth dokumentacionit që ka të bëjë me këmbimin e pronës së paluajtshme, duke thënë se në vendimin e këtij këmbimi mungon sipërfaqja e këmbimit. Po ashtu, edhe në skicën e cila është punuar nga Drejtoria e Pronës, nga zyrtarët e kësaj drejtorie, mungon sipërfaqja e parcelës 1998/1, e cila do të këmbëhet. Pra në këtë rast po këmbëhen 20 ha me 8 ha. Ajo kërkoi të dijë se a mund të realizohet këmbimi i këtyre parcelave të cilat nuk janë në kufi kadastral. Pasi që nuk janë në kufi kadastral, atëherë a po arrihet përmbushja e interesit publik?! Përderisa këto prona që këmbëhen nuk janë në kufi me parcelën komunale, çfarë interesi publik ka Komuna, për të bërë këtë këmbim?!

Berat Lahu, fillimisht ngriti shqetësim rreth këtij propozimvendimi, i cili tha se përderisa ky propozim nuk e plotëson as kushtin formal për këmbim, përndryshe bën edhe shkelje ligjore, andaj kërkoi të dijë se cili është interesi publik që Komuna e Prishtinës ta pranojë kërkesën e palës për këmbim të pronave. Konsideroi se pa e marrë vlerësimin e Ministrisë së Financave, e cila ta përcakton në bazë të vlerës që ajo e jep, se sa metra katororë duhet të jenë për pronën që po synohet me e marrë, atëherë ne nuk kemi pse e diskutojmë këtu këtë këmbim, dhe pa këto dy elemente, ky vendim tani është bllanko.

Triera Kasumi - Berisha, para se të votohet, kërkoi nga ekzekutivi të dihet se cili është interesi publik për këmbimin e kësaj prone.

Lidhur me çështjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Doruntinë Maloku, drejtore, dhe Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rahman Haradinit dhe Shaban Kongjelit.

Pika e tretë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Bahtir) Demollit, Albert (Bajram) Mavriqit, Remzush (Bajram) Mavriqit, Hysen (Bajram) Mavriqit dhe Arben (Bajram) Mavriqit.

Arsyeshmërinë për votimin e këtij propozimvendimi e paraqiti Doruntinë Maloku, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Bahtir) Demollit, Albert (Bajram) Mavriqit, Remzush (Bajram) Mavriqit, Hysen (Bajram) Mavriqit dhe Arben (Bajram) Mavriqit.

Pika e katërt

Projektregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.

Lihur me Projektregullorën për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Florian Dushi, drejtor.

Sami Salihu, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve në këtë ndërmarrje, tha se duke pasur parasysh se përgjatë këtyre dymbëdhjetë muajve të fundit, kjo ndërmarrje ka argumentuar se ka përmirësuar gjendjen e përgjithshme të ndërmarrjes, investimet adekuate janë duke u ndërmarrë, keqpërdorimet janë goditur dhe ndaluar, kontratat e shtrenjëta të cilat i kemi gjetur janë shkëputur, po ashtu ka performancë më të mirë financiare, me rritje prej 15%, të të hyrave të përgjithshme nga viti i kaluar. Deri më tani "Prishtina Parking" operon deri në orën 19:00, pas votimit të kësaj rregulloreje do të operojë deri në ora 23:00, në të dy zonat.

Kërkojmë që të votohet kjo rregullore, e cila është plotësisht në favor të banorëve rezidentë të kryeqytetit dhe do t'i sigurojë ndërmarrjes siguri financiare dhe mbi të gjitha rregull dhe rend.

Lidhe me shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Florian Dushi, drejtor, dhe Alban Zogaj, nënkryetar.

Petrit Reçica tha se për ta votuar këtë rregullore, për ta pasur mbështetjen tonë për këtë rregullore, duhet bërë disa ndryshime, jo komplet rregullorja. Ne i kemi disa propozime, të cilat në vijim të diskutimeve do t'i paraqesim.

Triera Kasumi-Berisha, në më të GP të LVV-së, tha se kjo rregullore është në kundërshtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës. Për këtë ne kemi disa propozime për ndryshimet e neneve të kësaj rregulloreje:

Neni 3, pika 4, që ka të bëjë me çmimorën, ne propozojmë me u riformuluar ky nen; neni 19, pika 2, pika 3 dhe pika 4, po ashtu me u korrigju; neni 21, pika 3, ne propozojmë që pika 3 e neni 21 të largohet komplet, po ashtu pika 11 e këtij neni të korrigjohet; neni 22, pika 1 të korrigjohet, që minutazha prej 5 minutave të jetë 10 minuta. Po ashtu, pika 2 e neni 22 të largohet, sepse është kompetencë e policisë, pika 4 të korrigjohet, pika 5 të korrigjohet, pika 6, të korrigjohet, pika 8 të hiqet, si dhe pika 9 e këtij neni të korrigjohet, neni 25 të korrigjohet. Te çmimorja, është pika 1, 2 dhe 3, ne propozojmë që banorët rezidentë të kenë pagësën 10 euro në muaj dhe 100 euro në vit për regjistrimin e veturës së dytë.

Faqe4nga15

Te Zona I, parkingjet me laura, pika 1.1.3, propozojmë që kjo të rregullohet përmes rregullores.

Te Zona II, parkingjet rrugore dhe jashtërrugore, pika 1.2.12, propozojmë që të jetë: Banorët rezidentë me pagësë prej 10 euro në muaj apo 100 euro në vit për regjistrimin e automjetit të dytë.

Te Zona II, parkingjet me laura, nenin 1.1.8, propozojmë që kjo të rregullohet përmes rregullores së ndërmarrjes e jo përmes kryeshefit.

Ne si GP propozojmë që të shtohet edhe një nen i ri në nenin 23, pika 1.8. " Krijimi i një komisioni nga Kuvendi, me përbërje nga anëtarët të secilit subjekt politik, me dy ekspertë të jashtëm nga fusha e IT-së për monitorimin e soft-uerit të ndërmarrjes për menaxhimin e të hyrave dhe financave.

Bahri Gashi tha se kjo rregullore duhet të diskutohet nen për nen, kështu që ne si grup parlamentar i kemi propozimet tona, propozojmë që ato të inkorporohen në këtë projekt rregullore.

Ne propozojmë që të bëhen këto ndryshime: Te neni 4, pika 7, propozojmë që prej 3 vjetve të jetë 6 vjet operimi; neni 19, pika 4, pagesa e parkimit në parkingjet me laura në Zonën I dhe II, të bëhet përmes bankës jo me kesh; neni 20, pika 1.4, të korrigohet ky nen, kjo duhet me u sanksionuar, në bazë të rregullores me u definu parkingjet.

Nenin 1.1 veturat zyrtare të Komunës së Prishtinës, të definohen se kush ka të drejt me u parku rrugëve pas orës 4, jo me germën "Z" me qenë nëpër parkingje; Neni 1.4, të korrigohet, që edhe disa hapësira të caktuara Qeverisë së Republikës së Kosovës, duhet të ju lejohen disa hapësira për parking gjatë orarit të punës. Po ashtu, propozoj që të korrigohet edhe neni 25.

Sami Boroci, propozoi që në nenin 11 të parashihen edhe vendosj e kamerave në hapësirat ku i menaxhon "Prishtina Parking". Neni 12.2 të korrigohet, edhe neni 13.1 të korrigohet, te neni 15, te çmimi i biletës orëshe, propozoj gjithashtu që edhe ky nen të korrigohet.

Po ashtu neni 22, pika 1, pjesa e minutazhës, propozoj që të jetë deri në 10 minuta.

Te çmoria te Zona I, pika 1.2.3, te pagesa mujore për banorët rezidentë, propozoj që për veturën e dytë të jet 20 euro, dhe te pika 1.2.4, për veturën e tretë të jetë 30 euro për banorët rezidentë.

Fiknete Bejta, tha se me shumicën e propozimeve të dhëna nga znj. Kasumi pajtohëm, mirëpo kam një mëdyshje te propozimi për formimin e një komisioni për mbikëqyrjen e sistemit soft- uerit të "Prishtina Parking", me qenë se Ligji për menaxhimin e ndërmarrjeve publike përcakton sakt se kush është titullari i menaxhimit prej Kuvendit në ndërmarrjet publike, e që është Komisioni i aksionarëve, mendoj se ne po krijojmë dykuptimsi në ligjin.

Nora Kelmendi propozoi që në këtë rregullore të futet një nen i ri: "Nuk lejohen parkingje me laura për banorët rezidentë", pasi që këto laura e bëjnë bllokimin e lagjeve dhe nuk ka barazi rreth qytetarëve rezidentë.

Berat Lahu, tha se sa i përket formimit të një komisioni për mbikëqyrjen e soft uerit të ndërmarrjes, mendoj se një propozim i tillë qëndron dhe është i ligjshëm, prandaj mendoj se këtij propozimi ne duhet ti japim përkrahje për inkorporimin e tij në këtë rregullore.

Po ashtu, te parkingjet me laura dhe ato komerciale, ka sens për nga ana e përgjegjësisë së ndërmarrjes në raport me veturën e parkuar të qytetarit, mirëpo te parkingjet e banorëve rezidentë

është shumë vështirë e realizueshme, sepse përreth ka objekte banesore, qoshe e gjëra të ndryshme afër kopshteve të fëmijëve, parqeve të lodrave e kështu me radhë, e para është problem nga aspekti logjistik.

Endrit Gashi propozoi që punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje t'u paguhet shujta dhe të kenë sigurim të punës.

Agim Kuleta, lidhur me propozimin e Endrit Gashit, tha se vetë titulli tregon Projektregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, do të thotë ideja është qysh me i rregulluar dhe me i menaxhuar parkingjet, e tash shujtat e punëtorëve janë krejt tjetër dhe mendoj se është jo profesionale me e shti në këtë rregullore. Andaj propozoj që Bordi i ndërmarrjes të marrë vendim për këtë çështje, por si natyrë nuk shkon me këtë rregullore, është jo profesionale, se po flasim për menaxhim të hapësirave dhe parkingjeve.

Jeta Rafuna - Hasani e kundërshtoj fuqishëm propozimin për formimin e një komisioni paralel në ndërmarrjen "Prishtina Parking", kur dihet mirëfilli se ajo ndërmarrje funksionon me aksionarë dhe aksionarët e kan bordin e vet dhe menaxhmentin.

Bahri Gashi u shpreh se nuk dua me paragjykuar se a ka keqpërdorime në ndërmarrjen e parkingut dhe nuk e di a ka, po flitet që ka keqpërdorime shumë të mëdha. Ne ende nuk e kemi pasur një raport të asnjë ndërmarrjeje që ju po i menaxhoni me këshillat e aksionarëve që i kenë. Derisa ne nuk i shohim këto raporte, ju vazhdimisht do të akuzoheni për keqpërdorime si strukturë, nëse nuk ka raporte, nëse nuk dimë sa ka para, borxhe ndërmarrja, sa ka të hyra, sa ka obligime, atëherë ka vend për dallavere, ka vend për dyshime etj.

Arianit Beqiri tha se propozimet tona duhet të merren parasysh, kështu që sa i përket regjistrimit të veturës së dytë, vetura e dytë nuk është luks, duke i pasur parasysh se si është gjendja me trafikun, sidomos me qarkullimin e qytetarëve brenda, për neve vetura e dytë është domosdoshmëri e kohës. Kur të rregullohet transporti publik, atëherë mund të themi se veturës së dytë mund t'i ngritet vlera, por në atë kohë do të jenë rrethana tjera, ne qëndrojmë prapa kërkesës sonë që sot për sot 10 euro në muaj është çmim real. Përveç kësaj propozimet tona duhet të dalin në votim.

Valbona Ajeti tha se me Ligjin për qeverisje lokale, Kuvendi komunal i secilit qytet ka të drejtë të miratojë rregullore, por edhe ka të drejtë ta ndryshojë aty ku konsiderohet se plotësohen nevojat e qytetarëve dhe tani duhet ta hudhim në votim dhe ti votojmë një nga një ato propozime që u dhanë.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit, sqarime shtesë dhan Florian Dushi, drejtor, Përparim Rama, kryetar dhe Alban Zogaj, nënkryetar.

Kryesuesi një nga një i hodhi në votim propozimet e dhëna, që ato të inkorporohen të tekstin final të kësaj rregulloreje.

Propozimet dhëna nga GP i LVV-së, GP i AAK-s dhe GP i AKR-së, u miratuan që ato të inkorporohen në Projektregullorën për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.

Propozimi i dhënë për çmimore, që ka të bëjë me Zonën I, parkingjet rrugore dhe jasht rrugore, për pikën 1.2.3, ku propozohet: "Banorët rezidentë me pagesë prej 20 euro në muaj dhe 200 euro në vit për regjistrimin e automjetit të dytë".

Për këtë propozim votuan 11 për dhe 16 kundër dhe propozimi si i tillë nuk u miratua.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, u miratua Rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.

Pika e pestë

Propozim-vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria”, 2023 – 2031.

Lidhur me Propozim-vendimin për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria”, 2023 – 2031, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Mimoza Sylejmani, drejtore.

Florim Krasniqi, përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në formë elektronike bëri elaborimin e Plani rregullues të hollësishëm të lagjes “Kalabria”.

Arianit Beqiri tha se ne i kemi disa vërejte rreth këtij propozim-vendimi, dhe si vërejtje e parë është çështja e ngritjes së koeficientit 7 në disa zona të lagjes, që me këtë koeficient mundësohet ose lejohet ndërtimi i objekteve deri në 40 kate. Pyetja dhe paqartësia jonë është se me koeficientin 2.4 është vlerësuar që zona ngarkohet shumë, atëherë çfarë pritet të jetë me koeficientin 7 në këtë pjesë?! Vërejtja e dytë ka të bëjë me uljen e koeficientit të disa parcelave të lagjes, ku disa pronarëve të parcelave iu është ulur koeficienti deri në 1.5, krejt kjo e papranueshme për ne dhe vlerësojmë se atyre banorëve po ju bëhet e padrejtë në kurriz të dikujt tjetër. Ndërsa si vërejtje e tretë, që lidhet me koeficientin 7, ka të bëjë me rrezikun potencial që plani i propozuar në këtë formë mos ta kalojë ligjshmërinë, për shkak se potencialisht ndërtimet e parapara në zona me koeficient të lartë rrezikojnë sigurinë kombëtare. Ne si grup ju njoftojmë, poashtu edhe banorët, se në rast të mosreflektimit të hartuesve dhe propozuesve të çështjeve të ngritura më sipër, në rast të mospërmirësimit të tyre, ne do të reagojmë dhe do të bëjmë çdo gjë që në ato pika të pamundësojmë miratimin përfundimtar të këtij propozim-plani.

Jeta Rafuna tha se si LDK e mirëpresim këtë projektdokument që të shkojë në diskutim publik dhe mandej gjatë diskutimit t’i shikojmë kërkesat dhe diskutimet apo komentet e banorëve.

Bahri Gashi pyeti se pse brenda Kalabrisë ka disa shkëlqe apo lëshime, ose gabime që disa familje janë dëmtuar seriozisht dhe në mesin e tyre një biznes që është dëmtuar seriozisht, ku e ka pasur 1.5 apo 1.8 koeficientin dhe shumica e kanë 2.4. Unë e përkrah gjithsesi këtë projekt që të shkojë në diskutim publik, por kërkoj një unifikim për të gjithë që të mos dëmtohet dikush.

Gëzim Mehmeti, sa i përket këtij propozim-vendimi, tha se kjo do të thotë se neve sot na keni sjellë para lajthitjeve dhe nuk është duke u mbrojt interesi publik, por është interesi i cili është privatizuar në këtë pjesë, me argumente dhe për atë arsye kjo lajthitje ka mohuar të drejtën elementare të banorëve të këtyre zonave, çka nënkupton se kjo dikujt iu është ulur me dëshirë dhe dikujt i është ngritur koeficienti. Për këtë çështje është mirë të dini pse është shtyrë kjo për dy vjet, nuk është shtyrë për barazi, nuk është shtyrë për çështje tuaja, por është shtyrë për çështje të interesave.

Mirsad Vitia tha se është e rëndësishme që kërkesat e grupit tonë të trajtohen, në mënyrë që ky plan të miratohet kur të sillet sërish në seancë.

Berat Lahu tha se për banorët e kësaj lagjeje mund të ndodhë ngritja, por jo ulja e koeficientit, sepse ata e kanë pasur një të drejtë të fituar të dhënë nga ky Kuvend me koeficient 2.4. Sot po votojmë për lënien në diskutim publik të këtij plani dhe hapi i parë që duhet të bëhet nga grupi punues dhe nga drejtoria, është që të korrigohet kjo dhe pastaj debati të zhvillohet mbi këto premisa, që në këto parcela do të ndodh ky ndryshim për shkak se tashmë Komuna e Prishtinës e ka pasur një obligim ndaj këtyre banorëve dhe një dëmtim i tillë është përveçse joetik, është edhe i papranueshëm ligjërisht.

Faton Zeka tha se anulimi i këtij plani nuk ka pasur asnjëherë arsyeshmëri për neve si banorë, por ja që kuvendet komunale në përgjithësi, dhe kuvendi nacional mund të marrë vendime që janë në shpërputhje me interesat e banorëve. Kërkojmë që, në emër të banorëve, të përfillen kërkesat tona, të rregullohen të gjitha paqartësitë, le të përfillen kërkesat e banorëve për barazi në ndërtim, le të mendohen shumë mirë ku kanë me u vendosur shkollat, çerdhet dhe nevojat sociale etj.

Sami Boroci tha se nëse në këto parcela ka emra të personave privatë, nuk do ta votoj këtë plan, nëse vjen me emra privatë me koeficientin 7, gjë që këtë pjesë duhet trajtuar dhe të mos vijë edhe njëherë e me dështuar, se mandej që po i mbajmë peng banorët e lagjes “Kalabria”.

Dasmor Durmishi kërkoi të dijë se kush ka qenë në grup punues të këtij plani dhe cili është qëllimi i rritjes së koeficientit të pronës komunale. Nëse po, atëherë si është menduar me u trajtuar dhe çka përfiton Komuna prej rritjes së koeficientit të pronës komunale?

Amir Simnica tha se të gjitha sugjerimet, vërejtjet, ulja e koeficientit që juve si banorë ju mundojnë, besoj shumë që do të merren parasysh. Gjithashtu edhe ne si grup parlamentar do të jemi të vëmendshëm në kërkesat dhe në takimet që do të vini ju gjatë dëgjimit publik.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Florim Krasniqi, përfaqësues nga drejtoria përkatëse, dhe Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konsatatoi se më 29 vota për, u miratua Vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria”, 2023-2031, në Prishtinë.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona ekonomike”.

Lidhur me këtë propozimvendim të pranishmit i informoi Mimoza Sylejmani, drejtore.

Gëzim Sveçla tha se në revidimin e këtij plani ne kemi vërejtje, të cilat janë të pashmangshme në vlerësimin tonë, ka shumë kontradikta dhe paqartësi në arsyetimin për nevojat e revidimit të planit. Ne jemi për zhvillim të qytetit, jemi për zona ekonomike edhe për kampuse sportive dhe çdo gjë tjetër që i kontribuon zhvillimit ekonomik e sportiv. Megjithatë, me informata të mangëta, pa dokumente e pa plane konkrete këto të mbesin vetëm vizatime të mira, dhe do të kemi disa këmbime ose shpronësime të pronave private, ku do të përfitojnë individ të caktuar dhe hapësira atje do të mbetet e pashfrytëzuar.

Jeta Rafuna theksoi se Grup i asambleistëve të LDK-së e përkrah vendimin për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona ekonomike", duke e marrë parasysht zhvillimin e qytetit që do të ndodhë në atë pjesë.

Gëzim Mehmeti tha se neve na është prezantuar një plan, ku dhe do të jemi mikpritës për lojërat olimpike, të jetë në tri faqe, të kalojë pa asnjë detaj, mendoj se nuk qëndron. Këto janë ato mungesat që nuk kemi detaje në këtë drejtim dhe si i tillë duke u bazuar në mangësinë e dokumenteve dhe vizatimeve amatoreske, është i papranueshëm të kalojë pa një studim të mirëfilltë.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Mimoza Sylejmani, drejtore, dhe Përparim Rama, kryetar.

Duke pasur parasysht çështjet e ngritura nga parafolësit rreth vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna, Mimoza Sylejmani, drejtore, propozoi që kjo pikë e rendit të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të silltet për diskutim në njërin prej seancave të radhës së Kuvendit.

Pika e shtatë

Propozimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, i dt. 16.06.2010.

Lidhur me Propozimrregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, i dt. 16.06.2010, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

Petrit Reçica tha se për ta votuar këtë rregullore ne kërkojmë që pika 15.6 komplet me u larguar dhe orari mos me qenë prej orës 08:00 deri në 23:00, por prej orës 08:00 deri në 22:00 për shkak se nëse punojnë deri në orën 23:00, ja ulë dëshirën barnatoreve për me e mbajtur kujdestarinë.

Fiknete Bejta tha se e përkrahu propozimin e z. Reçica për largimin e nenit 15.6, por do të ishte mirë të përcaktohej një komision, i cili do ta shqyrtonte këtë kërkesë dhe të jepen rekomandime edhe të kryetarit, në mënyrë që ose të refuzohet ose të aprovohet një gjë e tillë ose kërkesa e tillë. Gjithashtu, mendoj se edhe neni 15.5 duhet të riformulohet, kështu që mendoj se këto dy nene duhet të rishqyrtohen. Kisha sugjeruar që për t'u zgjidhur këto probleme të formohet ky komision, që bazë e tij kishte me qenë njerëzit profesionalisht të zgjedhur.

Gëzim Sveçla shprehu mendimin se të gjithë jemi të pajtimit që gjendja në këtë drejtim nuk është e mirë dhe duhet me ndryshuar diçka, kështu që neni 15.6 duhet të hiqet nga kjo rregullore, po ashtu edhe pagesa prej 2000 euro që parasheh për leje të veçantë, as që duhet diskutuar. Vetë fakti i mundësisë për leje të veçant për punë shtesë, e krijon njëfarë monopoli tek disa farmacistë të fortë.

Radie Hoxhaj tha se është një problem në Komunën e Prishtinës, sepse këtu nuk ekziston një dyqan për pajisje ortopedike dhe ekzistojnë nja tre a katër që janë privat dhe punojnë sipas dëshirës, kështu që ju pyes se a keni menduar për këtë problem që është shumë serioz.

Faqe9nga15

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Izet Sadiku, drejtor. Po ashtu, duke pasur parasysh të gjitha vërejtjet e dhëna, propozoj që pika 15.6 të hiqet nga rregullorja.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, i dt. 16.06.2010.

Pika e tetë

Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit në mes Kryeqytetit Prishtina dhe Kryqytetit Kuwait city.

Arsyeshmërinë për miratimin e këtij propozimvendimi e paraqiti Përparim Rama, kryetar. **Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për nismën e bashkëpunimit në mes Kryeqytetit Prishtina dhe Kryqytetit Kuwait city.**

Pika e nëntë

Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024.

Lidhur me Planin vjetor të punës së Kuvendit, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Osman Bllaca, i cili tha se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, GP i LVV-së ka kërkuar që të nxirret një statistikë në lidhje me implementimin e planit të përgjithshëm, pasi që ky grup parlamentar nuk është i përfaqësuar në këtë grup punues.

Gëzim Sveçla theksoi se LVV-ja nuk merr pjesë në këtë grup punues.

Endrit Gashi tha se GP i AAK-së nuk ka emër për këtë grup punues.

Osman Bllaca theksoi se për anëtarë të grupit punues u propozuan: Pëllumb Bajçinovi, kryesues i komisionit, Sami Boroci, AAK, Fiknete Bejta, LDK, Endrit Zabërxha, NISMA, Agim Kuleta, LB, Dasmor Durmishi, LDK, Vigan Kastrati, përfaqësues nga ekzekutivi, Diellon Gjonbalaj, përfaqësues nga Zyra ligjore dhe Luljeta Selimi, përfaqësues nga Shërbimi i Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 17 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024.

Pika e dhjetë

Propozim-vendimi për lirim nga pagesa për pjesëtarët e Policisë së Kosovë, për shërbimet që ofrohen në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucionet tjera shëndetësore që menaxhohen nga kryeqyteti.

Faqe10nga15

Gëzim Sveçla tha se propozimi është i qartë, ajo çka ka ndodh në nivelin qendror në një marrëveshje në mes të SSHKUK-së dhe Policisë së Kosovës, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në nivelin sekondar dhe terciar. Propozojmë që e njëjta t'i ofrohet në nivelin primar, konkretisht Policia e Kosovës, të jenë të liruar nga participimi për shërbime të cilat i marrin në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucione tjera shëndetësore me të cilat menaxhon Kryeqyteti, andaj ju ftojmë ta përkrahin këtë propozim.

Elmira Nikçi - Rexha tha se sot Policia e Kosovës është e poshtëruar nga qeverisja e VV-së në çdo aspekt, ata janë pa paga meritore, pa sigurim dhe pa shtesa të rrezikshmërisë, andaj ju kolegë të VV-së lëreni hipokrizinë, sepse kjo që po kërkohet sot është tallje, sepse është dashur që niveli qendror apo qeverisja juaj e pamend, të mendojë për këtë çështje dhe çështje të tjera.

Endrit Gashi tha se ne si grup e përkrahim këtë propozimvendim.

Gëzim Mehmeti theksoi se nëse ne subvencionojmë Trafikun Urban, pse të jetë problem me e subvencionuar Policinë e Kosovës, mos ta përdorim politikisht këtë çështje, të kalojë ky propozimvendim.

Triera Kasumi -Berisha tha se propozimi kur është bërë për policët me u liruar nga pagesa e trafikut urban ka qenë diskriminuese, sepse aty janë përfshi vetëm autobusat e trafikut urban dhe jo operatorët privatë të autobusave në trafikun urban, kështu që nuk mund të ngrehim paralele për diskriminime.

Amir Simnica u shpreh se ne në asnjë moment nuk kemi thënë që kemi me votuar kundër apo nuk e përkrahim këtë iniciativë. Ne si Grup parlamentar e përkrahim këtë iniciativë dhe nuk e kemi atë kulturë të diskutimit.

Radije Hoxhaj tha se unë nuk do të flas për politikë, po flas për pacientin, sepse nuk ka vizitë 1 euro, kështu që vizita me mjeku një pacienti mund t'i kushtojë deri në 30 euro, duke i llogaritur barnat, injeksionet etj.

Ajet Brajshori, duke pasur parasysh rrjedhjen e diskutimeve lidhur me këtë pikë, tha se forma e respektit të komunikimit dhe qasja në komunikim është kulturë njerëzore, andaj po ju bëj thirrje të reflektoni në te, sepse jemi audiencë që na shikon prindi, fëmija edhe qytetari edhe të gjithë. Tek ata duhet të mbjellim një kulturë të komunikimit dhe le ta kuptojë edhe qytetari se nuk jemi kundër policisë, kështu që këto debate të kësaj natyre nuk na bëjnë nder.

Lidhur me disa çështje të cilat u ngritën nga parafolësit, sqarime shtesë dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, u miratua Vendimi për lirimin nga pagesa për pjesëtarët e Policisë së Kosovë, për shërbimet që ofrohen në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucionet tjera shëndetësore që menaxhohen nga Kryeqyteti.

Gëzim Sveçla, për Kryetarin e Komunës:

- Nuk mbahet mend të ketë pasur më pak organizime e aktivitete për festën 28 Nëntori nga Komuna e Prishtinës sesa kësaj radhe. Pse ka ndodh kjo vobektësi e këtij aktiviteti kulturor?
- E dyta, ka të bëjë me përmendoret e papastërta. Është një dukuri e shëmtuar që po vazhdon tash e dy vjet. Gjatë nderimeve që qytetarët bëjnë për data të historisë tonë kombëtare, ata hasin në një gjendje të papranueshme të përmendoreve dhe me të vërtetë ky është një akt i shëmtuar.
- Çështja e tretë, ka të bëjë me tunelet në Kurriz. Këto janë ankesat e pyetjet që kemi marrë nga qytetarët e Prishtinës. Tunelet në kurriz që lidhin shkollën “Xhemajl Mustafa” me Kurrizin janë për shkak të ujërave të zeza, për shkak të ujërave të shiut që mbledhet aty dhe aromës tmerrësisht të rëndë. Këto tunele janë afër shkollës dhe paraqesin shumë problem për frekuentuesit, që më së shumti janë fëmijë.
- Një ankesë tjetër e kemi nga banorët e lagjes “Dardania”, lidhur me tymin e qebaptores “Bosna” që është aty, është duke paraqitur problem për banorët dhe është paraqitur disa herë ankesa në Inspeksion dhe nuk është vepruar deri më tani.
- Një çështje që është shumë aktuale këto ditë e për të cilën kemi marrë shumë ankesa, ka të bëjë me çmimin për çerdhe në komunitet. Çmimi bazë lidhur me rritjen e çmimit që ka ndodhur tani, është rritur shifra në 150 euro për një fëmijë, po flasim për çerdhe me bazë në komunitet. Kjo kosto është ngarkesë shtesë për familje, sidomos kush i ka dy e më shumë fëmijë. Pyetja është se pse ka ndodhur kjo rritje e çmimit dhe cilat janë mundësitë tona për të intervenuar në këtë rast.
- Po ashtu, kemi ankesa nga prindërit e nxënësve të shkollës “Gjergj Fishta” në lidhje me disa renovime që po zgjasin tej çdo planifikimi të kësaj kohe. Sipas informatave që i kemi marrë, mësimi atje po vazhdon të mbahet me orar të shkurtuar dhe është shqetësuese kjo, andaj kërkon veprim të menjëhershëm.
- Pyetja tjetër ka të bëjë me semaforët në lagjen “Bregu i Diellit”, të shkolla “Iliria”, janë aktivizuar vetëm njëherë për t’u testuar, pastaj nuk janë përdorur më. Pse po ndodh kjo, a kemi të bëjmë këtu me keqplanifikim, sepse në vlerësimin tonë ky është keqpërdorim i buxhetit.
- Pyetja tjetër ka të bëjë me procesin e adoptimit të qenëve endacakë. Sa është numri i adoptimeve tani edhe a mund ta quajmë këtë proces të dështuar?
- Rregullorja për veprimtarinë e lokalave hoteliere a është funksionale, a është aktive kjo kjo Rregullore? Ka pasur një kosto financiare, e cila iu ka rënë barrë lokaleve hoteliere, Rregullorja për zhurmën akustike për lokalet hoteliere, dhe a është funksionale, a po funksionon, sepse informatat janë ndryshe?
- Tani i kam tri kërkesa të banorëve të Bardhoshit. Atje është një fushë e futbollit, por një kohë të gjatë është jashtë funksionit dhe nuk është duke u përdorur për qëllimin për të cilin ekziston. Duke e ditur mungesën e fushave të tilla për futboll dhe duke pasur parasysh afërsinë që ka Bardhoshi me qytetin, vlerësojmë se kjo është një mundësi e mirë për ta funksionalizuar atë fushë dhe për ta vënë në dispozicion jo vetëm të Bardhoshit, por të të gjithë qytetit.
- Një kërkesë tjetër e banorëve të Bardhoshit ka të bëjë me rrethimin e varrezave, është një kërkesë e arsyeshme, legjitime që nuk ka kosto të madhe financiare dhe kërkojmë nga ju që të veproni në këtë drejtim. Bardhoshi e ka edhe një problem, që ka të bëjë me pronat e uzurpuara e që sipas banorëve një pjesë e tyre janë prona komunale. E di që kryeqyteti ka mungesa të

pronave komunale, kishte me qenë mirë që të iniconi procedura të identifikimit dhe lirimit të tyre dhe të njëjtat pastaj të përdoren për qëllim të kryeqytetit.

Arbnora Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Kërkesa lidhur me ndriçimin e fshatrave Barilevë dhe Prugofc. Në fshatin Barilevë është kërkesa në rrugën “Rrahim Koskoviku”, të bëhet ndriçimi i asaj pjese, pasi që në shumicën e lagjeve të Barilevës është bërë ndriçimi, është edhe për fshatin Prugofc, për lagjen e tretë, këtu të gjitha rrugicat janë të pandriçuara.

Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorin së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Kërkesë nga banorët e lagjes “Kodra e Trimave”, ata kërkojnë që t’u bëhet shtrirja, asfaltimi i një rruge e cila është në fund të rrugës “Nexhmi Llumnica”, afër rezervuarit të ujit, vendi i njohur “te baseni”, pra aty për rreth basenit është një rrugë në anën e djathtë dhe kërkohet të rregullohet e të vazhdojë deri te hoteli “Princi i Arbërit” dhe në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen edhe autobusin, që është mungesë në këtë pjesë. Po ashtu, të rregullohet edhe kanalizimi për rrugën “Besnik Lajqi”, që lidhet me rrugën “Nexhmi Llumnica” e “Bedri Ahmeti”. Prandaj kërkesa e banorëve është që të bëhet një zgjidhje sa më shpejt, sepse po paraqet problem shumë për banorët e kësaj pjese.
- Kur jemi te lagja “Kodra e Trimave”, ankesa tjetër vjen nga prindërit e nxënësve, ata ankohen se një rrugicë që është mbi shkollën “Hilmi Rakovica”, e të cilën nxënësit e frekuentojnë shumë, është dëmtuar tej mase dhe në këtë mënyrë po paraqet problem për vijimin e nxënësve në shkollë.
- Kërkesë edhe nga banorët e fshatit Bërrnicë e Epërme, ata kërkojnë të bëhet rregullimi, asfaltimi i këtyre rrugëve: “Shaqir Pllana”, “Afrim Hajrizi”, “Ismal Spahiu”, “Shaban Manaj” dhe rruga “Peja”. Kurse banorët e fshatit Bardhosh kërkojnë rregullimin e rrugës “Zef Lekaj”, e cila gjendet afër stacionit, për shkak të urgjencës, fillimisht kërkojnë, të shtrohet me zhavorr, e më pastaj të asfaltohet.
- Ndërsa në fshatin Sharban, banorët ankohen se punimet që kanë filluar në rrugën “Kështjella” janë duke shkuar në intensitet të dobët dhe në këtë mënyrë gjendja e rrugës, veç se është rënduar edhe më shumë.
- Kërkesa tjetër vjen nga banorët e lagjes “Qendra”, rruga “Sylejman Vokshi”, ata kërkojnë zhvendosjen e kontejnerëve të cilët janë vendosur thuajse afër rrugës, për shkak se po pengojnë trafikun në atë pjesë. Në këtë rrugë janë tri vende ku janë të vendosur kontejnerët, kurse ata kërkojnë vetëm tek pjesa që është afër rrugës, të zhvendosen në një vend më të përshtatshëm.

Gëzim Mehmeti, për drejtoren e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm:

- Plani zhvillimor komunal dhe harta zonale, kaluan dy vite dhe kur do ti kemi, sepse veç jemi në gjysmë të mandatit, përafërsisht ta dimë se po ka pyetje edhe prej qytetarëve.

Endrit Gashi, për kryetarin e Komunës:

- Është një problem, në lagjen “Bregu i Diellit”, rruga “Dervish Rozhaja”, pronarët kanë probleme pronësore, të cilat nuk janë bartur nga sistemi i kaluar. Pronarët nuk mundën t’i gëzojnë këto prona, duke u shfaqur se ato prona figurojnë në emër të Komunës. Kisha

pasul deshire qe kete ceshtje ta merim pak me senozism, sepse eshte ne interes te qytetarit.

Ermal Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Te rruga “Qamil Bala”, në lagjen “Bregu i Diellit”, aty rrjedh një kanalizim qe një kohë të gjatë. Ai kanalizim, vjen prej barakës që është pak metra më lart, aty kanë problem qytetarët, në veçanti fëmijët, sepse ndodhet në afërsi prej 50 metra, prej oborrit të shkollës “Ismail Qemali”, verës ka kundërmim të jashtëzakonshëm, nderesa dimrit paraqet rrezik nga formimi i shtresës së akullit, kështu që banorët kërkojnë që me urgjencë të rregullohet kanalizimi.

Valbona Ajeti, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe menaxhimit të Kontratave:

- Është shqetësim për banorët apo nxënësit e shkollës “Pavarësia”, ku para hyrjes prej kohësh është një kanalizim ku shpesh pastron, por prap është problem i njëjtë.
- Nga shtëpizat te sheshi “Xhorxh Bush”, po krijohet një papastërti nga hudhja e mbeturinave nga ato shtëpiza, andaj kërkoj që për evitimin e këtij problemi të merren masa.

Radie Hoxhaj, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Është e shkruar gabimiht rruga te spitali “Mark Dizdar”, ku në fakt duhet të jetë “Mak Dizdar”. Këtë çështje e kam ngritur edhe më herët, por deri më tani emri i kësaj rruge nuk është korrigjuar.
- “Bregu i Diellit” i ka dy krahë zona lindje – perëndim, e kemi vetëm një ambulancë. Për të shkuar në qytet nga ambulanca e ke autobusin nr.3, për t’u kthyer në shtëpi ose bënë vizitë në ambulancë, nuk ke fare autobus, duhet të shkojmë tek 4-shi. tek shkolla. Ne që nuk kemi vetura, automjete, po e kemi shumë vështirë, e që patjetër ajo zonë duhet ta ketë një linjë të autobusit.

Hafiz Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Një kërkesë që ka të bëjë me një deponi, e krijuar me mbeturina, në rrugën Llukar – Siqevë, problem i parashtruar para dy muajve me drejtorin, por nuk është marrë asnjë veprim. Ndoshta ajo më shumë që më detyron të marrë këtë iniciativë, është se kemi të bëjmë edhe me basenin e ujit, i cili e furnizon shkollën, pikërisht në atë pjesë, e ku janë duke u hedhur mbeturinat. Kështu që kryetar ju kisha lutur të angazhoni drejtorin, që sa më parë atë deponi ta largoni.

Endrit Zabërgja, për kryetarin e Komunës:

- Është një shqetësim që kohëve të fundit e kemi pranuar nga disa grupe të ndryshme, ku bëhet fjalë për Rregulloren e ndotjes akustike. Sipas informatave që i kemi, në kohën e caktuar, ky program ka ndaluar së funksionuari dhe ndoshta në momente të caktuara, kam informata se edhe si platformë, më shumë është fiktive sesa funksionale. Andaj nuk e di se cilët janë drejtorët e linjës, të cilët janë të përgjegjshëm për këtë çështje, mirëpo kjo është diçka e cila, vazhdimisht na ka preokupuar brenda disa çarqeve të këtij komuniteti.

Dasmor Durmishi, për kryetarin e Komunës:

- Në rrugën "Vëllezërit Fazliu", pemët që janë mbjellur janë hequr prej banorëve, prej lokaleve, kryesisht prej lokaleve që janë aty. Ju kisha sugjeruar që inspeksioni me i dënuar ato lokale.
- Sa u përket deponive, deponia që është te baseni kryesisht lart, është pronë e ujësjellësit edhe ate kemi me larguar së shpejti.

Arbnore Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Është kërkesë e prindëve të nxënësve të shkollës në fshatin Vranidoll, për vendosjen e disa policë të shtrirë në rrugë afër shkollës, dhe arsyeja e vendosjes së tyre është se magjistratja në mëngjes po është e ngarkuar dhe veturat po hyjnë në rrugicën që të shpije tek shkolla dhe po i rrezikojnë nxënësit.

Lidhur me petjet dhe kërkesat e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar, Valbona Makolli, drejtoreshë, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë, Donat Lushaku, drejtor, Arbër Sadiki, drejtor.

Pika e dymbëdhjetë

Të ndryshme.

Hafiz Krasniqi, kërkoi nga kryesuesi i Kuvendit që ta zbatonjë Rregulloren për punën e Kuvendit, kështu që kërkoi të dijë se deri ku lejohet ta them ajo etika e veprimt, që një asamblist fizikisht i ofrohet kolegut me vërsulje fizike dhe kjo të jetë praktika e fundit. Kjo vlen për Gëzim Sveçlën. Në aspektin rregullativ dhe të Rregullores së Kuvendit, deri ku kem të drejtë dhe se çfarë masa duhet të merren në raste të tilla. Kisha dëshiruar që kjo sjellje të jetë e fundit.

Për çështjen e ngritur nga z. Krasniqi, përgjigje dha Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit.

Gëzim Sveçla tha se arsyeja pse jam afruar është për shkak të zërit, dhe nuk ju afrova për të kërcënuar, se nuk është subjekt që duhet të kërcënohet. Nëse është ndjerë i kërcënuar unë po i tregojë se nuk kam ambicieje që ai të jetë i kërcënuar, e për kërcënimin që më bëri nuk është problem, unë këtu jam.

Mbledhja përfundoi në orën 18:30.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Pëllumb Bajçinovci**



Faqe 15 nga 15